

**VENDIM**  
**Nr. 109, datë 10.2.2016**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 238, DATË 23.3.2011, TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE, “PËR SHPALLJEN E QENDRËS HISTORIKE TË QYTETIT TË  
KORÇËS DHE MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ADMINISTRIMIN E SAJ”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 29, pika 4, e 53, pika 2, të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në rregulloren për administrimin e Qendrës Historike të qytetit të Korçës, miratuar me vendimin nr. 238, datë 23.3.2011, të Këshillit të Ministrave, fjalia e fundit, e nenit 11, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Kriteret e shfrytëzimit të monumenteve të kulturës përfshirë, “Pazarin e Korçës”, përcaktohen nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, në përputhje me ligjin nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar. Aktivitetet që do të zhvillohen në to miratohen me vendim të Këshillit të Bashkisë Korçë, në bazë të këtyre kriterëve.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**